



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2021:004669  
Datë: 31.05.2021  
Numri i dokumentit: 01833143  
P.nr.07/2021

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË** - Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Gëzim Ademi, me Praktikantin e rregullt të kësaj gjykate Fidaim Tahiri, në lëndën penale ndaj të pandehurit: S.J. nga Mitrovica, me vendbanim ne Komunen e Zveqanit, për shkak të veprës penale: Posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge neni 269 par.1 të KPRK-së, duke vendosur sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.1967/2020, të datës 12.01.2021, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar me datë 26.05.2021 në prezencën e të pandehurit dhe Prokurorit te Shtetit, me datën 27.05.2021 shpalli aktgjykimin, ndërsa me datë 31.05.2021 përpiloi këtë:

**A K T G J Y K I M**

I akuzuari:

S.J., me nofkën “S.”,nga i ati N. dhe e ëma J., e vajzërisë D., “data e lindjes”..., në Mitrovicë, tani me vendbanim në Komunen e Zveqanit, i pa martuar, ka të kryer shkollën e mesme, i pa punësuar, i gjendjes së mesme ekonomike, me parë i pa dënuar, me numër Personal:..., Serb, Shtetas i Republikës së Kosovës.

**ËSHTË FAJTOR**

Sepse;

Me datën 26.09.2020, rreth orës 18:40 minuta, ne shëtitoren ne Mitrovicë afër urës kryesore pa autorizim ka poseduar dy qese me substanca psikotrope – marihuanë, e cila përmban tetrahidrokanabinol (THC), ne peshë prej 3,90 gram, e qe gjate kontroll është nga njësia hetimore DHTM ne Mitrovicë-veri, sasia e cekur prej dy qese janë gjetur dhe konfiskuar. Pra pa autorizim ka poseduar substanca psikotrope për përdorim personal qe e kishte marr nga personi N.N ne Mitrovicë.

Me këtë ka kryer veprën penale: Posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge neni 269 par.1 të KPRK-së.

Andaj, Gjykata, në bazë të nenit 1, 4, 7, 17, 21, 38, 39, 40, 42, 43, 46, 47, 48, 49, 69, lidhur me nenin 269 par.1 të KPRK-se, dhe nenit 365, 450, të KPP-së, e:

## G J Y K O N

1. Dënim me burg me kusht në kohëzgjatje prej tre (3) muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri nuk kryen vepër tjetër penale gjatë periudhës së verifikimit, në kohëzgjatje prej një (1) viti nga plotfuqishmëria e këtij Aktgjykimi dhe;
2. Dënim me gjobë në shumë prej 250€ (dyqind e pesëdhjetë euro), i cili dënim duhet të paguhet brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga plotfuqishmëria e këtij Aktgjykimi. Nëse i akuzuari nuk e paguan gjobën në afatin e caktuar, Gjykata do të veprojë në bazë të nenit 43 par.3 të KPRK-së deri në zëvendësimin e dënimit me gjobë me dënim me burgim duke llogaritur 20 € (euro) për një ditë të kaluar me burg.
3. Në mbështetje të nenit 269 par.3 të KKPRK-së e lidhur me nenin 282 par.2 nenpar.2.4 të KPP-se, ndaj të pandehurit urdhërohet edhe: Konfiskimi i sendeve dhe atë:
  - a) Substanca narkotike e cila përmban kanabis (Marihuanë) që përmban tetrahidrokanabinol (THC), domethënë 3,90 gram.
  - b) Urdhërohet policia e Kosovës që ta shkatërroj substancën e konfiskuar.
4. Obligohet i pandehuri, që t'i paguajë shpenzimet e procedurës gjyqësore dhe atë në emër të paushallit gjyqësorë të paguaj shumë prej 10€, ndërsa në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit shumë prej 30€, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
5. Kërkesë pasurore juridik, nuk pati.

## A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm ka ngritur Aktakuzën PP.II.nr.1967/2020, të datës 12.01.2021, kundër të pandehurit: S.J. nga Mitrovica, me vendbanim Komuna e Zveqanit, për shkak të veprës penale: Posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge neni 269 par.1 të KPRK-së.

Gjykata ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar me datën 26.05.2021, ashtu që në këtë seancë i pandehuri e ka pranuar fajësinë në tërësi sipas aktakuzës, duke theksuar: Se e ndien veten fajtorë për këtë vepër penale, i premtoj gjykatës që në të ardhmen nuk do të përsëris këtë vepër penale, më vjen keq për rastin që ka ndodhur, e kam përdorur për arsye dhe rrethanat personale kam menduar se do të ma zbut situatën por konsumimi ma ka vështirësuar.

Prokurori, lidhur me pranimin e fajësisë ka dhënë mendimin se janë pambushur kushtet ligjore për pranimin e fajësisë, Pajtohem me pranimin e fajësisë e nga ana e të pandehurit i cili është dhënë në bazë vullnetare dhe propozoj, gjykatës që pranimin e fajësisë të pranoj dhe të merr parasysh si rrethanë lehtësuese, gjatë matjes së lartësisë dhe llojit të dënimit për të pandehurin.

Gjykata, ka shqyrtuar pranimin e fajësisë të cilën e ka deklaruar i pandehuri, e në mbështetje të nenit 248 të KPP-ës, në këtë drejtim vlerëson se janë përbushur kushtet ligjore për pranimin e fajësisë për të pandehurin. Gjykata, ka vërtetuar se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit, mbështetet në provat me të cilat disponon kjo gjykatë si: Raporti fillestar i incidentit me nr. 2020-DHTN-463 i datës 26.09.2020, Raporti i policit i datës 26.09.2020, shënimi zyrtar 2020-DHTN-463 i datës 26.09.2020, Procesverbal mbi marrjen në pyetje të të dyshuarit i datës 28.09.2020, Procesverbal mbi marrjen në pyetje të dëshmitarit I.J. i datës 28.09.2020 Raportin e ekspertimit

të Agjencisë së Kosovës për Forenzikë me nr. referues AKF/2020-.../2020-..., të datës 20.10.2020, Vërtetimi mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve, i datës 26.09.2020, procesverbali për kontroll dhe sekuestrim të përkohshëm i datës 26.11.2020, fotoalbumi me gjithsej 3 foto. Të gjitha këto prova janë bindëse për gjykatën dhe formojnë elementin inkriminues e që në bazë e tyre dhe pranimi të fajësisë, konsiderojmë se për tej çdo dyshimi është vërtetuar se i pandehuri, ka kryer veprën penale që i vihet në barrë.

Gjykata, ka vërtetuar se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit është bërë në mënyrë vullnetare, se i pandehuri ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë, duke i'u tërhequr vërejtja të pandehurit se pas pranimi të fajësisë, ai nuk mund të bëjë ankesë për shkak të konstatimit të gabuar të gjendjes faktike, por vetëm sa i përket llojit dhe lartësisë së dënimit, gjykata ka vërtetuar se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabim faktik, nga këto arsye gjykata e ka aprovuar pranimin e fajësisë të bërë nga i pandehuri.

Gjykata, nga pranimi i fajësisë se të pandehurit dhe nga provat e cekura si më lart, ka vërtetuar përtej dyshimit të bazuar se i pandehuri ka kryer veprën penale: Posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge neni 269 par.1 të KPRK-së, Kryesi që kryen veprën nga paragrafi 1. i këtij neni kushdo që pa autorizim posedon narkotikë, substanca psikotrope apo analoge dënohet me dënim me gjobë dhe me burgim prej një (1) deri në tre (3) vjet.

Lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata ka pasur parasysh vlerësimin e rrethanave lehtësuese dhe rënduese për matjen e dënimit në mbështetje të nenit 69 të KPRK-ës. Gjykata, si rrethanë rënduese për të pandehurin ka gjetur mënyrën e kryerjes se veprës penale, rrethanat në të cilat është kryer vepra penale, shkallën e përgjegjësisë penale – dashjen direktë dhe motivin për ta kryer veprën penale.

Ndërsa, si rrethanë lehtësuese gjykata e ka vlerësuar pranimin e fajësisë në tërësi për veprën penale, rrethanat personale që i njëjti rezultojnë të jetë i moshës së re, i pa pune, i ka premtuar gjykatës se nuk do të përsëris më veprën penale, po ashtu dhe faktin se për të njëjtin ishte hera e parë që kishte rënë ndesh me ligjin.

Duke marrë parasysh të gjitha këto rrethana si dhe shkallën e rrezikshmërisë shoqërore, gjykata vlerëson se, shqiptimi i dënimit me burg të kushtëzuar dhe dënimin me gjobë ndaj të pandehurit është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurit. Po ashtu, Gjykata vlerëson se edhe me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit nga neni 38 të KPRK-së, që t'i parandaloj kryerësit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tyre, si dhe të parandaloj personat tjerë nga kryerja e veprave penale si dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit. Po ashtu, ky dënim do të shërbejë si masë preventive që në të ardhmen i pandehuri të përmbahen nga çfarëdo veprimi që janë të dëmshme për shoqërinë në përgjithësi.

Gjykata, si në dispozitiv të Aktgjykimit ndaj të pandehurit, ka shqiptuar edhe konfiskimin e substancës narkotike, duke marrë për bazë sigurinë juridike po ashtu të njëjtat janë sende që është rezultat i kryerjes së veprës penale siç vërtetohet më lartë, në mbështetje të nenit 282 par.1 e lidhur me par.2 nënpar.2.4 të KPP, ku përcakton se kimikatet, fabrikat, pajisjet laboratorike apo substancat e krijuara apo të përdorura në veprën penale nga nenet 272 deri 280 të KPRK, pasuria që është qenësish e paligjshme i nënshtrohet automatikisht konfiskimit pa marr parasysh gjetjet e gjyqtarit lidhur me fajësinë apo pafajësinë e të pandehurit, e lidhur me nenin 269 par.3 të

KPRK-së, i cili përcakton se substancat narkotike dhe substancat e tjera konfiskohen, andaj për shkak të këtyre konstatimeve gjykata ka vendosur si në dispozitiv për konfiskimin e tyre.

Vendimin për shpenzimet e procedurës gjykata e ka marrë në bazë të nenit 450 par. 2 pika 2.6 të KPP-së, që kanë të bëjnë me shpenzimet e paushallit gjyqësor.

Ndërsa taksa për kompensimin viktimave të krimit, në kuptim të nenit 39 par.3 të Ligjit nr. 05\L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Sa i përket kërkesës pasurore juridike gjykata ka vendosur si në dispozitiv, duke u bazuar në faktin se në aktakuzë nuk kishte të propozuar palë të dëmtuar.

Andaj gjykata duke u bazuar me neni 365, 450, 463 të KPPK-ës nga arsyeje e lartcekura ka vendosur si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË**  
**Departamenti i Përgjithshëm**  
**P.nr.07/2021, dt.31.05.2021**

**Procesmbajtësi:**  
Fidaim Tahiri

**G j y q t a r i:**  
Gëzim ADEMI

---

**Këshillë juridike:** Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, llogaritur nga dita e pranimit të tij. Ankesa dorëzohet përmes kësaj Gjykate, në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.